

KRYQËZIMET LETRARE NË VEPRËN HASTA LA VISTA

Meral SHABANI-VESELI¹, Besarta RAMADANI²

¹Katedra e gjuhës dhe letërsisë shqipe, Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit
Universiteti i Evropës Juglindore –Tetovë

1Email: m.shehabi@seeu.edu.mk

²Magjistër i letërsisë, Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit

2Email: br21659@seeu.edu.mk

Përmbledhej

Bazuar në teorinë e intertekstualitetit që nënkupton se asnjë tekst nuk mund të shihet ndaras nga konteksti i tij, apo teksti nga i cili e ka fillin e krijimit, ashtu edhe në letërsi është një koncept që përdoret për të përshkruar teknikat dhe strategjitë që shkrimtarët përdorin për të reflektuar mbi veten e tyre në veprat e tyre letrare, por edhe për të krijuar kryqëzime letrare mes teksteve. Kjo mund të përfshijë shprehjen e emocioneve personale, reflektimin mbi eksperiencat e tyre personale dhe shfaqjen e mendimeve dhe ideve të tyre mbi letërsinë dhe botën në përgjithësi. Kjo shkakton përzierjen e realitetit me fiksimin e qëndrimit subjektiv të shkrimtarit dhe pastaj i lë lexuesit të formojë vetë marrëdhënien me tekstin dhe interpretimin e tij. Në punim do të gjinden elemente të kryqëzimeve letrare mes autorëve Petro Markos dhe Ernest Heminguejit duke vënë në dukje pikëtakimet e veprave, personazheve dhe vetë jetën e autorëve. Metodologjia që do të përdoret do të jetë ajo analizës, krahasimit duke dhënë rezultatet e kërkimit teorik.

Fjalët çelës: *Intertekstualiteti, Petro Marko, Ernest Heminguej, simbolika, Hasta la vista, Për kë bien këmbanat.*

Abstrakt:

Based on the theory of intertextuality that implies that no text can be seen separately from its context or the text from which it originated, in literature, it is a concept used to describe the techniques and strategies that writers use to reflect on themselves in their literary works, but also to create literary cross-references between texts. This can include the expression of personal emotions, reflection on their personal experiences, and the presentation of their thoughts and ideas about literature and the world in general. This causes a mixture of reality with the writer's subjective stance and then leaves the reader to form their own relationship with the text and its interpretation. The paper will include elements of literary cross-references between authors Petro Markos and Ernest Hemingway, highlighting the key points of their works, characters, and the authors' own lives. The methodology used will be that of analysis, comparison, providing the results of theoretical research.

Key words: *Intertextuality, Petro Marko, Ernest Hemingway, symbolism, Hasta la vista, For whom the bell tolls.*

Hyrje

Teoritë moderne për analizën e tekstit letrar kanë ardhë në përfundim se kuptimi i një teksti varet nga interteksti. Pra, kuptimi i tyre nuk është i pavarur por mbështetet në një tekst që është shkruar përpara tij. Për të gjetur intertekstin gjatë leximit të kryeveprës së Xhejms Xhojsit “Uliksi” duhet të lexojmë “Odisenë” e Homerit. Duke lexuar “Lahutën e Malcisë” poashtu gjejmë intertekstin te Homeri. Kështu, leximi i romanit “Hasta la vista” të çon te “Për kë bie kambana”. Mirlinda Krifca-Beqiri thotë se: *“teoritë bashkëkohore tekstin e kuptojnë jo si tekst, por si intertekst.”* (Krifca, 2005, f.15).

Kur i qasemi studimit të intertekstit të një vepër, nuk vëzhgohen vetëm karakteristikat e autorit, por interteksti si një zinxhir lidh shumë tekste të tjera qofshin ato letrare, historike apo kulturore. Ashtu siç thotë dhe Aristoteli çdo gjë është imitim nisur nga kjo mund të gjejmë intertekstin në çdo vepër artistike. Asnjë shkrimtar nuk mund të nis nga hiçi. Edhe nëse ai është origjinal dhe libri i tij nuk është i ngjashëm me asnjë vepër letrare, ai përsëri ka kapur diçka nga jashtë, nga përditshmëria njerëzore, nga ajo që ai sheh dhe dëgjon çdo ditë. Pra, kuptojmë që ndikimi ose mbështetja në vepër letrare, është e pashmangshme.

Kur Petroja shkroi në autobiografinë e tij *“i këputur më shumë nga mendimet sesa nga vuajtjet fizike”* (Marko, 2000, f.255). Ai nuk e mori fjalinë e Heminguejit *“Më shumë më rëndojnë mendimet sesa hekurat”* (Marko, 2000, f.225) para vetes për të shkruar diçka të ngjajshme, por ai e ka dëgjuar këtë fjali, e ka në nënvetëdije se diçka të përafërt ka lexuar ndonjëherë dhe ndoshta i pavetëdijshëm për këtë ngjashmëri, krijon fjalinë e tij. Nuk përjashtohen rastet kur Petroja nuk ka dashur ta ndryshojë fjalinë nga Hemingueji dhe e ka shkruar shumë të ngjashëm, siç është dhe shembulli: *“Ç’kurvëri është lufta!”* (Heminguej, 2003, f. 365) *“Ah, kjo kurvë luftë!”* (Marko, 2002, f.188).

Siç shprehet dhe Meral Shehabi-Veseli tek studimi *“Miti si intertekstet në poezitë e Naim Frashërit”* *“Qëllimi i këtij komparacioni është që t’i vështrojmë nga afër këta dy tekste dhe kontekstet e tyre, t’i zbresim në një sferë më të dukshme për komperacionin”* (Shehabi, Meral, *Gjuha, letërsia dhe kultura shqiptare, nga pavarësia deri më sot*, 2012, f.175). Me leximin e dy romaneve gjenden elemente të intertekstit të hapur sepse vetë Petroja pohon që romani i Heminguejit ishte një shtysë për të për ta shkruar romanin e tij dhe ne si lexues e kemi të lehtë për të gjetur tekstin bazë.

Pas gjetjes së elementeve të përbashkëta dhe intertekstit kuptojmë se dy autorët paraqitën në romane përjetimet e tyre personale duke i rrëfyer me mjeshtërinë më të lartë artistike. Gjatë hulumtimit shihet se çdonjëri prej tyre e ka sjellë romanin në mënyrën e tij krijuese që sa mund ta krahasosh me tjetrin aq dhe gjen dallime të mëdha.

1.1.Simbolika e kabanës në vepër

“Të gjitha historitë, po që se vazhdojnë shumë, përfundojnë me vdekje, dhe s’ka rrëfyes të vërtetë që të mund ta shpëtojë dot nga kjo” (Heminguej, 2008, f.114).

Simboli është figurë stilistike përdorimin e të cilit e hasim shpesh në romanet në fjalë. Roli i simbolit është që të jep një ide ose dukuri duke e zëvendësuar me diçka tjetër, i cili do të marrë një kuptim më të thellë. Simboli mund të kuptohet dhe si shenjë. Pra, *“një shenjë që mund të kuptohet për objektin të cilin e nënkupton njeriu me të parë atë shenjë.”* (Rrahmani, 2008, f.208). Simboli i jep një kuptim të dytë një sendit, frymorit apo ndonjë dukurie tjetër. Hemingueji me titullin që i ka vendosur veprës na lë hapësirë për të menduar se çfarë fshihet pas domethënies së tij. Gjatë leximit të Petros, kjo gjë përforcohet edhe më shumë.

“Për kë bie kambana” hapet me shprehjen e poetit të njohur anglez Xhon Done që llogaritet si e dhënë paratekstuale, e cila vendoset në mënyrë të hapur në formë të references në fillim të romanit: *“Askush nuk është një ishull më vete; çdo njeri është pjesë e kontinentit, një copë e së njëjtës tokë... Vdekja e çdo njeriu më pakëson edhe mua, sepse unë jam pjesë e njerëzimit dhe kështu askush s’e di me siguri për kë bie këmbana; ajo mund të bjerë edhe për ty”* (Heminguaj, 2003).

Por çfarë simbolizon rënia e kambanës? Kur kambana bie ajo lëshon tinguj të fuqishëm që njofton diçka që ka ndodhur. Ajo diçkaja është vdekja. Pikërisht për këtë gjë, kambana është kthyer në simbol, rënia e të cilës simbolizon vdekjen. Nga një send siç është kambana i jepet një kuptim i ri, i cili është më domethënës. Çdokush që dëgjon kambanën, gjëja e parë që i shkon në mendje është vdekja. Është e lidhur aq ngushtë shenja me kuptimin sa që nuk shihen më si të ndara. Kambana nuk shihet më vetëm si një mjet me formë që bën zhurmë.

Hemingueji i ka gjetur titullin e përshtatshëm romanit të tij, që lidhet me ngjarjet në roman. Tema është lufta dhe lufta sjell vdekje. Kur vdes njeriu kambana bie, por për kë bie ajo? Këtu vlen mendimi i shkrimtarit Xhon Done që e përmendëm më lartë. Ajo bie për këdo, sot për tjetrin nesër për ty. Simbolika e kambanës është e përshtatshme për çdo periudhë, sidomos për luftra siç ishte ajo e Spanjës. Këtu dëgjohej fuqishëm sepse ajo filloi në Spanjë dhe do vazhdojë në gjithë botën, se Xhon Done thotë *“ajo mund të bjerë për ty”*. Kur ajo binte për Spanjën, binte për tjetrin, nesër ajo ra për të gjithë njerëzimin.

Petro Markos nuk i ik nga dora ky element, që do e përfshijë si tek *“Hasta la vista”*, poashtu dhe te *“Intërvistë me vetveten”*. Kjo kambanë e frikëson atë sepse është i vetëdijshëm se nëse sot ajo bie në Spanjë, nesër tingujt e saj do t’i dëgjojmë dhe në Shqipëri. Ai e dinte se lufta kishte filluar atje dhe do lëshonte rrënjet dhe në vendin e tij. Por kjo nuk ishte e vetmja arsye, ai ishte një njeri human, që nuk ia donte të keqen tjetrit, andaj dhe tek autobiografia e tij thotë: *“Pse nuk dëgjoni ju kambanën e Spanjës? Nuk dini ju ç’bëhet në Spanjë?”* (Marko, 2000, f.193). Apo kur ai tregon se rënia e kambanës shuan çdo ëndërr njerëzore dhe se rënia e saj ishte fundi i episodeve të jetës së njeriut: *“Kjo është një etapë me rëndësi e maratonës sime drejt frontit të lirisë, kambana e të cilit ishte aq bubulluese, sa humbiste çdo tingull tjetër të ëndrrave, mendimeve dhe episodeve të tjera...”* (Marko, 2000, f.192).

Shqetësimin e rëniës së kambanës që lajmëron vetëm vdekje dhe vdekje, e shpreh autori dhe te *“Hasta la vista”*. Aq e fuqishme është kjo kambanë, zëri tingullues i saj si një vajtim për njeriun dëgjohej ngado se: *“Kambana që bie në Spanjë, do ta zgjojë edhe marokenin!”* (Marko, 2002, f.53). Kjo kambanë që bie në fshatrat e Spanjës, arrin të kaloj Gibraltarin. Figurativisht ajo arrin të çaj kodra e male, të kaloj dete e oqeanë dhe të shkoj në vesh të njeriut, të atij që ky tingull ia dridh zemrën. Ka një episode te Marko ku kambanat kishin ndaluar së rëni. Arsyeja ishte se ushtarët i kishin lidhur fashistët për kambanash. Një hakmarrje e ëmbël e popullit që kishin ndaluar rëniën e kambanës pikërisht nëpërmjet atyre që ishin shkaku kryesorë që kambana nuk ndalej së rëni. *“Kurse kambanat nuk binin, se i kishin lidhur fashistët e ngujuar aty”* (Marko, 2002, f.228). Vdekjet e të rinjve luftëtar ishin shumë. Me humbjen e të riut, humb dhe ardhmëria dhe pikërisht në atë Spanjë *“ku kambanat bien orë e çast me tinguj të përmotshëm për lulen e rinisë që shkon e shkon përjetë...!”* (Marko, 2002, f.237)

1.2. Tradhtia në luftë

Kryqëzimet letrare janë edhe në aspektin e komunikimit të personazheve në veprat, të cilat dialogëzojnë me njëra-tjetrën në shumë aspekte. Sprovat në të cilët kalojnë luftëtarët janë të shumtë, nga më të vështirat, dhe tradhtia është njëra nga këto. Të paktë ishin personazhët e Heminguejit dhe të Petros, të cilët nuk qëndruan besnik deri në fund. Autorët nga fillimi na lënë të kuptojmë se karakteret e këtyre personazhëve ishin të paqëndrueshëm, ideali i tyre nuk ishte i lartë dhe qëllimi i tyre nuk ishte i qartë. Por, pavarësisht se kishim personazhe, të cilët nuk donin të luftonin për të mirën e njerëzimit, Petro Marko ua mveshi atyre karakterin e frikacakut, që ta arsyetojë këtë mosqëndrueshmëri të tyre, sepse në fund të fundit ata ishin nga Shqipëria. Pavarësisht se xha Kola, “ky plak misterioz”, ishte në mesin e vullnetarëve, ai kishte ardhur në luftë për qëllime të tjera. Nga fillim autori na jep disa elemente që na bëjnë të dyshojmë për qëndrueshmërinë e karakterit të tij. Më vonë në vepër, e kuptojmë fytyrën e vërtet të tij. Siç shkruan dhe autori në fillim të romanit: “*Ai, sa dëgjon krismë, “fësht” ia bën dhe zhduket*” (Marko, 2002, f.29). Xhemalit i hipi gjaku në kokë kur dëgjoji se si xha Kola po bënte dallavere. Ai kishte sjellë nga Spanja ikona kishash dhe i shiste ato. Të gjithë e kishin kuptuar karakterin e tij dhe e urrenin, por njëkohësisht e dinin se ai ka qenë pjesë e vullnetarëve. Por, në mesin e vullnetarëve ka pasur avanturier, siç thoshte dhe Xhemali “*ka dërguar armiku edhe njerëz të tij atje*” (Marko, 2002, f.359). Ai tradhtoi miqtë e tij dhe veten duke mos qëndruar besnik idealit. Ashtu siç ishte dhe Farruk Gucia, i cili s’ishte njeri për t’u besuar. Ai kishte ardhur në Luftën e Spanjës jo për të luftuar por për t’u arratisur nga vendi pasi e kishte çnderuar një vajzë, të cilën e kishte lënë dhe shtatzënë dhe se ishte njeri i mbytur në borxhe dhe ikja në Spanjë ishte e vetmja zgjidhje për të për t’u larguar nga gabimet e tij. Por, karakteri i tij nuk ndryshoi, ai shfrytëzoi këtë kohë trazirash për ta ushtruar avazin e vjetër.

Te “Intërvistë me vetveten” Petro Marko flet për Faikun, i cili të kujton personazhin e Farrukut. Ai vazhdimisht helmonte atmosferën me mendimet e tij *pesimiste* “*Kot luftojmë! Luftën e kemi të humbur! Të gjithë do të vritemi!*” (Marko, 2000, f.235) duke i dekurajuar ushtarët e tjerë. Si Faiku ashtu dhe Faruku, ishin disfatistë të trembur që nuk bënë ndonjë trimëri në front. Qëllimi i Faikut në luftë ishte i qartë. Ai nuk kishte ardhur aty për idealin e tij sepse mendja e tij ishte diku tjetër. “*Faiku vetëm për gra fliste*” (Marko, 2000, f.229) thoshte Petro te autobiografia e tij dhe se gjithmonë kishin kujdes nga ai se mos bënte ndonjë gjë.

Një nga momentet ku autori flet për rrezikun e Kolonës së Pestë është episodi i dy vajzave që ndodheshin në shtëpinë ku u strehuan Gori dhe të tjerët. Aty ishin dy vajza, babai i të cilave punonte në postën e Kasturës. Ushtarët kishin filluar të dyshonin. Vajzat kishin shkruar një letër ku tregonin për brigadën e antifashistëve dhe përgatitjeve që bënin ata për sulm. Ushtarët vepruan me kohë dhe gjetën gjurmët e tradhtisë. Ata e kishin përballë armikun por i tradhtoi para syve sepse “*Armiku që ke këtu, është një mijë herë më i rrezikshëm se armiku që ke përballë.*” (Marko, 2002, f. 40). Pikërisht ky armik që gjendet në mesin e ushtarëve antifashist, që bën sikur lufton nën flamurin e antifashizmit, është më i rrezikshmi nga gjithë të tjerët, madje më i rrezikshëm se tërë divizioni armik. Ky është një nga episodet e shumta të tradhtive në luftë. Armiku arrinte të depërtonte në forma të ndryshme duke përdorur çdo njeri, pa përjashtime. “*Si oktapodi ka shtrirë këmbët tradhtia... Ajo na hëngri!*” (Marko, 2002, f.275). Ky është krahasimi më i përshtatshëm që mund t’i bëhet këtij fenomeni që “*kishte ngritur bajrakun e saj mbi pirgje kufomash*” (Marko, 2002, f.272)

Jozeja që në fillim na paraqitet si një personazh, i cili fokusin e ka te Anita edhe atëherë kur ai u martua me shoqen e saj edhe atëherë kur Anita e refuzon në mënyrë absolute. Por, mendja e tij i punonte vetëm për këtë gjë. Andaj lexuesit dyshojnë në karakterin e tij jo të mirë për shkak të

veprimeve të pamatura, egoiste por në fund bindemi për karakterin e tij negativ. Në fund ritakimi i Anitës dhe Jozesë dhe përlëshjes me fjalë mes tyre, duke shkuar deri në dhunë fizike, na e vërteton plotësisht se Jozeja ishte një nga tradhtarët veshur me uniform republikane por spiun i armiqve. Jozita (Anita) pasi mendohej me çdo kusht të çlirohej nga duart e tij, e qëllloi në fytyrë duke i thënë: *“Ti! Ti! Spiun e hale e kolonës së pestë, që ishe veshur edhe me uniformën e oficerit të ushtrisë sonë! Traidor! Traidor! Traidor! Traidor!”* (Marko, 2002, f. 384).

Armiqtë dërgojnë në mesin e ushtarëve antifashist të tjerë, të cilët do t'u shërbejnë atyre. Një emër tradhtari që përmendet te *“Hasta la vista”* ishte Peter Ewatt, një amerikan nga Kanadaja, i cili i dërgonte armikut numrin dhe emrat e vullnetarëve. Por, një personazh nuk mund të përmbys qëllimin e vërtetë të vullnetarëve të tjerë amerikan në luftë. Heminguei na dëshmon për besnikërinë e vullnetarëve amerikan nëpërmjet personazhëve të tij. Njeriu në luftë është i bashkuar me shumë të tjerë, por çdokush ka qëllimin dhe rolin e tij personal se *“Ç’do njeri ka dinjitetin e tij, ka nderin e tij, ka jetën e tij”* (Marko, 2002, f.309.). Është shumë e vështirë për ushtarët të qëndrojnë stoik përballë luftës dhe mos ndryshojnë karakterin e tyre. Shumica prej tyre devijojnë dhe në luftë ka *“gjithmonë shumë të këqinj, shumë pak të mirë. Ditë për ditë më pak të mirë”* (Hemingueit, 2003, f.162).

1.3. Lufta e gruas

Pos fatit tragjik, gruaja kishte një rol shumë të lartë në luftë. Historia na ka vërtetuar këtë. Të gjitha steriotipet e burrave se gratë nuk mund të bëjnë *“punë burrash”*, ranë poshtë në periudhën mes dy luftave botërore. Ata ishin më se të zojat për të kryer detyrat që u caktohej. Jo vetëm në uniformën ushtarake apo si vullnetare, por ato si nëna, si bashkëshorte, si motra, si vajza ua dhanë gjithë energjinë djemve, burrave, vëllezërve dhe prindërve të tyre. Shumë prej tyre dhanë dhe jeten. Për dallim nga Lufta e Parë dhe Lufta e Dytë, tek ajo e Spanjës shihet qartë prezenca e grave në luftë. Ata i përgatisnin gratë duke i trajnuar ashtu siç trajnonin burrat. Andaj dhe shohim te Petro Marko, vajza me uniformë, disa prej të cilave ishin fashiste.

Autorët nuk kishin se si të linin anash këtë pjesë të historisë duke na e sjellë nëpërmjet personazheve të tyre. Ata folën në emër të grave që nuk patën mundësi të flisnin vetë. Drita, Kristina, Anita ishin infermiere në shërbim të popullit spanjoll. Poashtu dhe personazhi i Besës te *“Stina e armëve”* e cila merrte pjesë drejtpërdrejtë në luftën antifashiste dhe ishte një nga emrat më të njohur që fashistët në Shqipëri ia kishin frikën. Pra, Petroja nëpërmjet personazhit të Besës, e ngrit femrën në një nivel shumë të lartë, të barabartë me burrat, duke i dhënë Besës tiparet e një vajze të vendosur, guximtare, e cila ka aftësinë dhe është e denjë për të udhëhequr luftën.

Te Hemingueji kishim vetëm dy femra që përfaqësonin fatin e shumë të tjerave. Maria nuk ishte infermiere, ajo ndoshta nuk kishte të veshur një uniformë por bashkë me Pilarin demonstuan se përkushtimi ndaj tjetrit është shërues. Roli i tyre ishte shumë i madh në ndihmën që i dhanë Robertos. Pa besimin e tyre Roberto nuk do arrinte të përmbushte punën që i ishte caktuar. Në këtë pikë ndahen dhe rrugët e Anitës dhe Marias për t'u takuar Anita me Katerinën e *“Lamtumirë armë”*, një infermiere që ishte krahu më i afërt i ushtarëve të plagosur, e cila dhe u dashurua në njërin prej tyre.

Vrasja e Jozesë te *“Hasta la vista”*, këtij oficeri që punonte në dëm të popullit, nga Jerma, ishte një akt revolte ndaj padrejtësive që i bëhej popullit spanjoll dhe gruas. Ashtu siç karakteri i fortë i Pilarit te *“Për kë bie kambana”*, e cila ishte dhe lidere e grupit, tregonte për rezistencën e grave ndaj çdo situatë që sillte lufta për gratë. Kërcënimet e saj ndaj bashkëshortit se do ta vraste në qoftë se ai tradhtonte njerëzit e tij, flet shumë për qëndrimin besnik të Pilarit ndaj luftës

antifashiste. Ajo ishte një grua e forte, e cila guxonte të jepte një gjykim dhe të bindte të tjerët të veprojnë sipas atij gjykimi. Ajo ishte një grua që nuk frikësohet të ketë një qëndrim dhe një opinion ndaj situatave të luftës, sepse besonte në forcën e vetvetes dhe në aftësitë e saj për t'i kuptuar këto situata.

Për nga karakteri, Jerma, kjo grua revolucionare, duket më e ngjajshme me Pilarin. Ajo sypatrembur po kryente një mision për të mirën e popullit spanjoll. Guximin dhe zgjuarësinë e saj do e tregoj se si arriti të kaloj në vendet më të rrezikshme, mbushur me ushtarë armiq, me një vajzë të bukur në krah, për të mbëritur tek vendi që i kishin caktuar për të dërguar mesazhin. Ajo kishte qenë nëna e dy dëshmorëve dhe ishte një femër e sprovuar nga lufta. Ajo ishte shumë e re kur ia vranë bashkëshortin. Ajo i rriti dy djemtë me thërrime në varfëri të skajshme, të cilët u rritën u bënë burra dolën vullnetarë për t'u vranë nga fashizmi. Jerma, kishte marrë forcë nga kjo tragjedi andaj trimëria dhe forca e saj nuk njihnin kufij.

Pilari, teto Tereza dhe Jerma, kishin të njëjtin rol kur bëhej fjalë për mbrojtjen e dy vajzave të reja, Marias dhe Anitës. Në prani të grave, ishte e vështirë për burrat t'i ngacmonin vajzat. Kështu ruhej Jozeja sa herë ishte e pranishme teto Tereza aty, ashtu i kërcënonte dhe Pilari burrat në qoftë se ndonjëri prekte Marian. Ajo ia dorëzoi Robertos Marian, pasi kuptoi karakterin e vërtet të tij. Dhe ishte Jerma ajo, e cila e shpëtoi Anitën përfundimisht nga dora e Jozesë. Teto Tereza pavarësisht se në moshë të thyer e nuk e mbanin këmbët, nuk e la Anitën një sekond vetëm kur ajo mes ushtarëve vraponte për të kërkuar Gorin, sepse ajo ishte e vetëdijshme se çfarë rreziku mund t'i kanosej në mesin e atyre burrave. Ajo i dha Anitës mbrojtjen e një nëne. Kur Anita po largohej për misionin e saj, teto Tereza i tha *"Kthehu shpejt... Të pret nëna! Të pret se u mësova me ty...!"* (Marko, 2002, f. 360). Sakrifika e këtyre grave duke rrezikuar jeten e tyre, ashtu siç bënin burrat në betejë, tregonte një forcë të pamasë. Gori në letrën e tij e porositi Anitën: *"Qëndro e fortë, si tërë të rejat e Spanjës... e të mijëra vajzave që ranë për lirinë e popullit"* (Marko, 2002, f.361).

Emri i Kristinës rishfaqes përsëri në vepër ku flitet për rezistencën dhe guximin e saj. Kur armiku po hynte dhe lajmi në spital ishte shpërndarë për t'u bërë gati brenda natës që të shpërngulen, shumë të plagosur arritën t'i hypnin në vagon por kishte nga ata që ishin të lënduar rëndë dhe ishte e pamundur t'i lëvizin nga shtrati sepse kishte rrezik të vdisnin menjëherë. Këtyre ushtarëve s'dinin çfarë t'u bënin por nuk mund as t'i linin vetëm. Kristina doli vullnetare dhe tha: *"Rri unë me ta!"* (Marko, 2002, f. 385). Ajo sakrifikoi rininë, ëndrrat dhe jetën e saj. Kristina e Stokholmit, kjo vajzë antifashiste me karakter dhe vullnet të fuqishëm për ta ndihmuar njeriun deri në fund, humbi veten.

1.4. Dashuritë e pamundura

Nuk është e lehtë të biesh në dashuri në luftë. Nuk ishte e lehtë as për Akilin, njërin nga burrat më të fuqishëm të letërsisë. Dhe dashuria e tij u mposhtë përballë luftës. Lufta është e pabesë, por e ka provuar se, pavarësisht kohëzgjatjes, njeriu mund të dashuroj. Nuk dimë sa histori dashurie në luftë kanë vdekur bashkë me protagonistët, por dimë se historitë më të jashtëzakonshme të dashurisë kanë ndodhur në luftë dhe janë shkruar në romanet historike.

Si të infektuar nga fundi i historive të dashurisë të personazhëve të Shekspirit, ata të Heminguejit dhe Petros, në çdo vepër të tyre, i ndiqte po i njëjti fund, ai tragjik, i pamundësisë për të qenë bashkë. *"Dashuria lindi në luftë"* thoshte Petro Marko (2002) *"dhe nuk arriti kulmin e saj, se edhe lufta vazhdonte..."* (f.451). Hemingueji ishte i bindur se *"gjithë historitë, po qe se vazhdojnë shumë, përfundojnë me vdekje"* (Heminguej, 2008, f. 114)

Lufta dhe pasojat e pasluftës ishin arsyeja kryesore për dashuritë e pamundura. Te romanet “Për kë bie kambana”, “Lamtumirë armë” fundi i dashurisë vjen nga vdekja e personazhit, ashtu siç vjen te ‘Nata e Ustikës dhe te ‘Qyteti i fundit’. Edhe te “Hasta la vista” nuk vjen shkaku i vdekjes, por vjen si pasojë e luftës. Këtë gjë e kuptojmë te libri “Dhe lind dielli” ku Hemingueji tregon historinë pas Luftës së Parë Botërore, ku ish ushtari ritakohet me infermieren që dashuroi në luftë, por ai tashmë është impotent dhe nuk mund ta gëzojë këtë takim dhe as dashurinë e saj.

Në luftë njeriu është i përgatitur për më të keqen prandaj personazhët e Heminguejit dhe Petros ishin të ndërtuar me durim dhe besim të plotë për luftë dhe liri, sa që dhe vdekja apo ndarja, sado tragjike dhe e dhimbshme, u përballua me forcë të madhe. Netët e fundit mes të dashuruarëve nuk ishin kaotike, ishin mjaftë të qeta krahas njëri-tjetrit, duke shijuar çdo çast sikur po përgatiteshin për ditë të kobshme që do të vinin.

“Hasta la vista” ishte përshendetja e tyre në takimin e parë të Gorit dhe Anitës, ashtu siç ishte dhe në takimin e tyre të fundit. Kjo përshëndetje ishte shpresë se ndoshta një ditë rrugët e tyre do t’i çojnë drejtë njëri-tjetrit ashtu siç ndodhi në fillim të historisë. Leoni e krahasoi këtë ndarje “me ndarjen e përkohshme të lirisë nga Spanja” (Marko, 200, f.449). Për fatin e keq, kjo ndarje e lirisë nga Spanja, zgjati më gjatë nga sa e prisnin, ashtu siç ndodh edhe me personazhet.

Më e vështirë ishte për Marian të jepte lamtumirën e fundit. Atë nuk e mbante më asnjë shpresë gjallë se një ditë gjithçka do të rregullohet. Ajo e dinte se gjithçka mbaron aty. “*Më ler të rri me ty. Lërmë të rri me ty!*” i lutej Maria, “*Unë jam me ty tash. Ne jemi të dy. Shko!*” i thoshte Roberto (Hemingua, 2003, f.365). Kjo ishte biseda e fundit mes tyre. Kjo dashuri ishte sa tragjike aq shëruese, që shtoi vlerën e jetës së tyre duke lehtësuar vuajtjet e luftës dhe plagët që u la ajo.

1.5. Shëmbëlltyra e personazhëve te autorët

Hemingueji dhe Petroja ishin njerëz, si gjithë të tjerët, modest, të dashur, me ideale të larta dhe me një karakter që shprehte forcë të madhe. Ata arritën të depërtojnë thellë në psikologjinë e njeriut të luftës, duke na dhënë personazhë të ndërtuar me mjeshtëri. Këtë e arritën duke i njohur ata për të cilët shkruan dhe duke pasqyruar veten e tyre te personazhët kryesore. Mënyra më e mirë për t’iu qasur analizës së veprave të tyre është duke lexuar biografinë e tyre. Duke vënë paralele dhe kryqëzime mes biografive të këtyre dy autorëve, është e pamundur të mos gjesh te ndonjë personazh vetë figurën e autorëve. Ata e ndanë historinë e jetës së tyre në shumë personazhe.

Episodët e shumtë që na jep Petro Marko tek autobiografia e tij “Intërvistë me vetveten”, sidomos kapitulli i Luftës së Spanjës, na lë të kuptojmë se përderisa vullnetarët e tjerë shqiptarë i ka paraqitur në vepër me emrat e tyre real, vetveten e ka treguar përmes personazhit të Gorit. Këtu gjejmë elemente autobiografike, që sipas teorisë së intertekstualitetit autori përdor elemente autoreferencijale. Autoreferencialiteti në letërsi mund të përdoret për të theksuar personalitetin e autorit dhe për të dhënë më shumë kuptim dhe thellësi te vepra. Në disa raste, autoreferencialiteti mund të ndikojë në perceptimin e lexuesit për veten e shkrimtarit dhe mund të konsiderohet si një formë egocentrizmi. Ai e shkruan jetëshkrimin e tij “*Pa u distancuar përmes personazhëve letrar, siç vepron në shumicën e romaneve.*” (Aliu, 2004, f. 37). Copëza të Petros mund të gjesh jo vetëm te Gori, por dhe te Andrea, personazh në romanin “Nata e Ustikës”. Poashtu dhe Heminguejin në librat e tij historik mund ta identifikojmë nëpërmjet të Robertos te “Për kë bie kambana”, të Xhejkut te “Dhe lind dielli”, të Filipit te “Kolona e Pestë”, të Henrit te “Lamtumirë armë”. Veprat e tyre janë dëshmi rrënoqethëse për jetët e tyre plot mundim dhe luftë për veten dhe tjetrin. Personazhët e tyre e përjetojnë rëndë çdo betejë, çdo shpërthim ashtu siç e përjetuan vetë

autorët. Plaga që mori Heminguejit në Luftën e Parë Botërore, si shofer ambulante, do ta pasqyrojë nëpërmjes personazhit të Henrit. Kjo plagë ishte më e thellë se ajo trupore, sepse ai shpërthim kishte depërtuar thellë në zemrën e tij.

Lufta e Spanjës më pas dhe internimi në Ustikë, nuk i kishte lodhur vetëm personazhet por dhe vetë Petro Markon. Pavarësisht se ai i përballoi me shumë guxim dhe dinjitet të gjithave. Nga “Intërvistë me vetveten” kuptojmë lodhjen e tij shpirtërore. Ka episode të shumtë ku tregon për rrugëtimin e Gorit në luftën e Spanjës. Kjo odisejadë është dhe e vetë autorit. Gori mendonte për këtë luftë, mendonte për idealin e tij dhe ishte entuziast, sepse ai donte t’i dëshmonte gjithë Shqipërisë se bijtë e tyre në Spanjë, do të vuajnë dhe do të lodhen vetëm për një qëllim të vetëm, të fitojnë lirinë e popullit. Këtë qëllim e kishte dhe vetë autori. Dashuria e Gorit ndaj miqve të luftës, shpreh qartë dashurinë e Petros ndaj tyre.

Petrua ua kushtoi librat bashkëluftëtarëve, për të cilët shkroi e rrëfeu trimëritë e tyre. Ai shkroi për miqësinë e tyre jo vetëm te “Hasta la vista” por dhe te “Intërvistë me vetveten”, sepse kjo miqësi ishte e denjë për t’u treguar. Gori ashtu si Petroja ishte patriot, i dashur ndonjëherë dhe naiv, revolucionar dhe i palëkundur në çështjet e tij. Ai ishte në gjendje të bëj gjithçka për tjetrin.

Nga ana tjetër Hemingueji thotë që pjesa më e madhe e personazhëve në prozën e tij janë të gjallë “*ndaj unë e kam shkruar atë me kujdesin më të madh, në mënyrë që askush të mos i njoh dot*” (Heminguej, 2008, f.119). Por, përsëri është shumë e qartë se personazhi kryesor në krijimtarinë e tij, është vetë Hemingueji. Ashtu siç ndodh edhe me Petro Markon, ata komunikojnë mes tyre edhe në aspektin e formimit të personazheve, duke iu referuar vetvetes. “Lamtumirë armë” ndjek historinë e një ushtari të plagosur, i cili u dashurua me infermierën e bukur angleze. Ky libër përmban një episod nga vetë jeta e Heminguejit edhe pse fundi i kësaj marrëdhënie, në libër është ndryshe nga realiteti. Poashtu “Për kë bie kambana” tregon vetë Heminguejin dhe botën psikologjike të tij, pas Luftës së Parë dhe gjatë Luftës së Spanjës, ku dhe ngjarja merr pjesë. “Dhe lind dielli” është një libër që flet për efektin që ka lufta të veteranët e Luftës së Parë Botërore. Personazhi me plagë të pashëruar nga lufta, mundohet të gjej kënaqësitë e jetes te pija, leximi, peshkimi dhe te sportet ekstreme siç ishte ndeshja me dema. Këta ishin sporte dhe hobi që Ernest Hemingueji i ka patur shumë përzemër dhe i kanë ndihmuar për të ikur nga realiteti jo pak shqetësues. Andaj dhe mund të themi se personazhët dhe autorët ecin krahas njëri-tjetrit si miq të pandarë.

Përfundimi

Nëpërmjet krahasimit paralel të veprave të Petro Markos dhe të Heminguejit mund të konstatohet se librat e tyre janë krijuar duke u mbështetur në rrethanat politike, historike dhe kulturore, ata kanë krijuar marrëdhënie intertekstuale me kontekstin e tyre. Të gjithë hipotezat e parashtruara më parë janë vërtetuar. Krijimtaria e Petros ka qenë risi për letërsinë tonë, duke u larguar nga e zakonshmja. Pavarësisht se shkaku i rrethanave ishte i vështirë të pranohet kjo gjë dhe se Petroja kishte vështirësi të mëdha derisa arriti të ndaj artin e tij me të tjerët dhe derisa të tjerët të adaptohen me këtë gjë, përsëri me një këmbëngulje të madhe ai vazhdoi të dhuroj nga vetja për historinë, letërsinë dhe kulturën tonë. Poashtu mund të theksohet se gjithë jeta e autorit, përfshirë aty fëmijërinë e tij, rininë, pjekurinë dhe moshën madhore, ka pasur një ndikim të jashtëzakonshëm në krijimtarinë e tij. Andaj, krahasimin e Petros dhe të Heminguejit mund ta bëjmë nga dy veprat e tyre kryesore, por poashtu dhe veprat e tjera të tyre bashkë më jetën që jetuan, na japin elemente të përbashkëta dhe shumë të ngjajshme për autorët. Ky krahasim dëshmoi se mjeshtria e penës së Petro Markos qëndron krahas penës së Heminguejit.

Bibliografia

- [1]. Marko, Petro. (2002), *Hasta la vista*, OMSCA-1, Tiranë
- [2]. Marko, Petro. (2000). *Intërvistë me vetveten*, OMSCA, Tiranë
- [3]. Hemingway, Ernest. (2001), *Dhe lind dielli*, Dituria, Tiranë
- [4]. Hemingway, Ernest. (2000), *A moveable feast*, Vintage, LondoHeminguej, Ernest. (2008), *Dëborat e Kilimanxharos*, Albas, Tiranë
- [5]. Hemingway, Ernest. (2003), *Për kë bie kambana*, OMBRA GVG, Tiranë
- [6]. Cvajg, Stefan. (2016) *Tolstoi*, Onufri, Tiranë
- [7]. Aliu, Ali. (2001) *Letërsia bashkëkohore shqiptare*, Albas, Tiranë
- [8]. waldhorn, Arthur. (2002) *A reader's guide to Ernest Hemingway*, Syracuse University Press, Neu York
- [9]. Churchill, Winston. (2004), *Lufta e Dytë Botërore vëllimi I*, Fan Noli, Tiranë
- [10]. Konferenca shkencore. (2009), *Petro Marko personalitet i shquar i letërsisë modern*, TRIPTIK, Vlorë
- [11]. Shabani, Emine. (2015), *Poetika dhe narracioni në romanet e luftës te Petro Marko dhe Ernest Hemingëay*, Tetovë
- [12]. Krifca, Mirlinda. (2005), *Intertekstualiteti në poezinë shqipe mes dy luftrave botërore*, Fakti, Shkup
- [13]. Rrahmani, Zejnuhall. (2008) *Teoria e letërsisë*, Faik Konica, Prishtinë